




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: Q.M. "Tema"
Numri Unik Identifikues: 810645591
Drejtor: Visar Hoti
OSHMA: Radio Tema
Adresa: Rr/Dëshmorët e Kombit nr.3/3 Ferizaj



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës si dhe ndryshimin e Kushteve të Termeve Teknike të Licencës së ofruesit të Shërbimeve mediale Radio Tema, me seli në Ferizaj

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Tema është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim regional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Ferizaj. KPM, me vendimin e datës 28 gusht 2016, lëshimin e licencës së Radio Tema për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 28 gusht 2023, skadon afati i licencës së Radio Tema.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Tema, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësinë e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 10 maj 2023, Radio Tema ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës dhe ndryshim të pjesës së dytë të Licencës (Kushtet dhe Termat Teknike të Licencës).

Arsyetim

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit*

të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.


6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Tema lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
7. Komisioni konstaton se, Radio Tema përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar si dhe ndryshim të pjesës së dytë të Licencës (Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës).
8. Komisioni vlerëson se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Tema të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
9. Komisioni konstaton se Radio Tema ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
10. Komisioni konstaton se Radio Tema së bashku me kërkesën për ripërtëritje të licencës ka parashtruar edhe kërkesën për ndryshim të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës, respektivisht modelit të transmetuesit, fuqisë maksimale të transmetimit (ERP), lartësia e antenës dhe drejtimi kryesor i antenës.
11. Komisioni konstaton se në bazë të analizave teknike të kryera nga zyrtarët e Departamentit për Menaxhim të Frekuencave (DMF) të KPM-së ndryshimet e propozuara janë në kuadër të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës (pjesa 2) dhe nuk paraqesin ndryshime të theksueshme dhe gjithashtu edhe mbulueshmëria është brenda kategorisë regjionale dhe si e tillë kjo kërkesë e Radio Tema është e pranueshme për ndryshim.
12. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së Radio Tema.
13. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës si dhe kërkesa për ndryshim në kushtet teknike të licencës së Radio Tema është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Tema i plotëson kushtet për miratim, dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon kjo radio.

Vendim

14. Komisioni në takimin e datës 13 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës për Radio Tema, në mënyrë që të vazhdojë me veprimtarinë e ofrimit

të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar, dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Tema.

15. Komisioni merr vendim për miratim të kërkesës së Radio Tema për ndryshim të Kushteve të Termeve Teknike të Licencës, respektivisht modelit të transmetuesit, fuqisë maksimale të transmetimit (ERP), lartësisë së antenës dhe drejtimit kryesorë të antenës dhe e ndryshimet e propozuara janë në kuadër të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës (pjesa 2) dhe nuk paraqesin ndryshime të theksueshme dhe gjithashtu edhe mbulueshmeria është brenda kategorisë regjionale.
16. Në rast të paraqitjes së interferencave në brezin frekuencorë, për arsye të këtyre ndryshimeve në parametrat teknike, Radio Tema obligohet të kthehet në parametrat teknike paraprake.
17. Licenca e Radio Tema do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.
18. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Tema, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, dhe harta e zonës së mbulimit, të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
19. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.09.2023

Datë